



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
24.11.2020, duke filluar në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Fadil Gashi dhe Genc Sherifi.

Munguan: Egzon Azemi, Vala Peshku, Sami Boroci dhe Blerand Stavileci.

Të pranishëm ishin edhe: Muhedin Nushi, nënkryetari i Komunës, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Vesel Makolli, anëtar i Kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues, duke thënë se sot jemi në mbledhjen jashtëzakonshme të KPF-së, që është kërkuar nga Kryetari, me këtë

### REND DITE:

1. Propozimvendimi për subvencionimin e qytetarëve të komunës së Prishtinës të infektuar me COVID-19.

**Muhedin Nushi**, nënkryetar, tha se para 2-3 ditësh kemi diskutuar me përfaqësuesit e GP-ve të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, rreth iniciativës së Kryetarit për subvencionimin e qytetarëve të infektuar nga COVID -19, për të gjithë qytetarët e infektuar, nga data 13 mars deri në datë pa afat, të evidentuar në listat e IKSHPK-së. D.m.th. kjo është thirrje e hapur, nënkupton që ka datë të fillimit, por nuk ka datë të përfundimit. Ne i kemi aktualisht rreth 13.800 qytetarë të infektuar me COVID -19, të cilëve iu takojnë, sipas propozimit të Kryetarit, nga 50 € subvencione për të gjithë ata që janë nën moshën 65 vjeç, ndërsa të infektuarve me COVID -19 mbi moshën 65 vjeç iu takojnë 100 €, siç u pajtuam në

takimin e fundit. Ky është propozim që e ka dhënë Kryetari i Komunës, ku të gjithë do t'i marrin pas aplikimit online. Ne jemi duke e përgatitur aplikimin online, ku të gjithë të infektuarit që janë në listën e IKSHPK-së që ne e marrim, do t'i marrin, d.m.th. nuk do të pranojmë aplikimet, ku qytetari është infektuar dhe parashtron kërkesë ndonjë test rapid apo serologjik, kryesisht këta janë të IKSHPK-së që ne i kemi. Ne kemi mundur me vepruar edhe ndryshe, me marrë listën e IKSHPK-së dhe me ua shpërndarë qytetarëve, por një mangësi aty që e kemi, është se në listë të IKSHPK-së nuk është llogaria bankare, dhe për këtë arsye po detyrohemi me bërë aplikimin, i cili është shumë i thjeshtë dhe ku krahasohen mandej informacionet nga aplikacioni dhe informacionet nga IKSHPK-ja.

**Halim Halimi** tha se ne si Grup parlamentar i LDK-së e kemi përkrahur dhe e përkrahim këtë iniciativë, që është në momentin e duhur, për t'iu ndihmuar atyre të cilët janë të prekur nga pandemia COVID-19. Të gjithë ne e dimë se 50 € është një shumë e vogël, por unë po besoj që udhëheqja e Komunës i ka analizuar mundësitë buxhetore për pagesën e kësaj shume për t'iu ndihmuar të prekurit me COVID -19. Andaj, nëse ka mundësi që këtë 50 € me bërë 100 €, se jemi dëshmitarë se shërimi i kësaj sëmundjeje kërkon mjete financiare shumë më shumë, kështu që me 50 € nuk mund të bëjnë asgjë, mirëpo më mirë 50 € se hiq.

**Muhedin Nushi** dha sqarime, duke thënë se kjo shumë është sipas analizave që i kemi bërë, dhe mundësia e vetme tash për tash, por në vitin e ardhshëm është planifikuar që kjo vlerë të rritet nga 50 € në 100 €, dhe këta që i marrin nga 50 € nëse vitin e ardhshëm bëhet 100 € do të kompensohen me 50 €, do të bisedojmë për vitin e ardhshëm.

**Agim Gashi** pyeti se a mund të merret vendim në seancën e nesërme për vlerën e vitit të ardhshëm apo presim një analizë tjetër.

**Muhedin Nushi** theksoi se e kishim pritur një analizë në vitin e ardhshëm, për arsye se nuk e dimë se si do të shkojë situata e pandemisë, e që pritet rritje e numrit në komunën e Prishtinës.

**Fadil Gashi** parashtrroi pyetje për kategorinë që janë me përkujdesje sociale se çfarë shumë do të marrin, se kjo kategori nuk u cek, vetëm këta që kanë qenë me COVID -19 nën moshën 65 vjeç, që i marrin 50 €, dhe mbi moshën 65 vjeç, që i marrin 100 €, por këta me gjendje sociale a do t'i marrin nga 50 € apo 100 €?

**Muhedin Nushi** u përgjigj, duke thënë se nga 50 € do t'i marrin të gjithë, dhe janë dy kategori që i kemi trajtuar edhe në takimin e fundit, që pensionistët të subvencionohen më tepër, në kategori tjera nuk kemi hy, edhe rastet sociale nëse janë të infektuar, do t'i marrin nga 50 €.

**Jeta Rafuna** pyeti për shifrën rreth 13.800 vetëve që i kemi të infektuar deri tani në komunën e Prishtinës, se a është e sigurt që të gjithë janë banorë të komunës së Prishtinës.

**Muhedin Nushi** dha sqarime, se pikërisht për këtë janë duke i përgatitur aplikacionet. Aplikacioni i cili tani përpilohet, kontrollohet numri i letërnjoftimit ose numri personal i letërnjoftimit, në numrin personal brenda është shifra ose numri, që e determinon se i cilës

komunë është qytetari, ka raste që nuk janë banorë të Prishtinës dhe besoj se numri është më i vogël, gjithsesi do të dalë numri më i vogël.

**Genc Sherifi** pyeti se a ka mundësi edhe për rastet sociale me u rritur shifra nga 50 € në 100 €, së paku për ta, sepse e dimë se janë kategori që kanë nevojë më shumë se pensionistët, kjo është e qëlluar.

**Osman Bllaca** dha sqarime, duke cekur se kategorinë sociale prej fillimit të pandemisë e kemi trajtuar në forma të ndryshme dhe iu kemi ndihmuar, iu kemi dhënë pako ushqimore. Gjithashtu, edhe Qeveria iu ka ndarë, për tre muaj dy ekstra pagesa i kanë pasur, kështu që, për mendimin tim na shkaktojnë tollovi, se tani duhet edhe me dëshmuar, me sjellë edhe kartelën që e dëshmon se janë raste sociale.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për subvencionimin e qytetarëve të komunës së Prishtinës të infektuar me COVID-19 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

*Mbledhja përfundoi në orën 11:20.*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta**

